

FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

Nr. 3236 Prot. Dt. 04/12/2024



Nr. 114/ Prot.

Date: 10/11/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KAVAJË

Nr. _____ prot

Kavaje me ____ / ____ /2024

FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

Nr. _____ prot

Tiranë me ____ / ____ /2024

AKTMARRËVESHJE
Për rindërtimin e stadiumit "BESA"

Në Kavajë, sot më datë __.12.2024, nënshkruhet kjo marrëveshje mes palëve të mëposhtme:

- I. **Bashkia Kavajë**, përfaqësuar nga Kryetari z. Fisnik Qosja, në mungesë të tij nga Sekretar i Përgjithshëm z. Arti Çiçolli.
- dhe
- II. **Federata Shqiptare e Futbollit**, person juridik Shqiptar, regjistruar me Vendimin nr.9 datë 31.07.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, Rruga "Liman Kaba", Nd. 5, Hyrja 1, Njësia Administrative 5, identifikuar me NIPT: J62008031T, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ilir Shulku (këtu e në vijim referuar si "FSHF");

Duke qenë se:

- Bashkia Kavajë është pronar i ligjshëm i stadiumit "BESA", ne qytetin e Kavajes,
- Bashkia Kavajë ne cilesine e titullarit te te drejtes se perfituesit te investimit te parashikuar per tu kryer me qellim rindertimin e stadiumit, ne bashkepunim me Federaten Shqiptare te Futbollit do te jete perfitues i vleres se shtuar te investimit.
- Rindertimi i stadiumit "BESA" permbush standartet e FIFA dhe UEFA per zhvillimin e ndeshjeve kombetare dhe nderkombetare, me mbeshtetjen e Federates Shqiptare te Futbollit.
- Mbi bazën e kësaj marrëveshje, Bashkia Kavajë, zotohet të verë në dispozicion Stadiumin "BESA", menjëherë dhe pa kundërshpërblim, sipas kërkesës së FSHF, në kohën dhe sipas modaliteve të përcaktuara nga kjo e fundit, me qëllim zhvillimin e të aktiviteteve ndërkombëtare sportive pa kufizim;
- Mbi bazën e nenit 33 të Ligjit nr. 79/2017 "Për sportin", E drejta e shfrytëzimit të objektit sportiv i takon autoritetit qe e zoteron, ne kete rast, Bashkia Kavaje, qe ka ne administrim objektin sportiv apo kujtdo tjetër të cilit ky i fundit i jep të drejtën e shfrytëzimit;

Duke konsideruar sa më sipër, palët, pas mbajtjes së takimeve të përbashkëta me Bashkinë Kavajë dhe Federatën Shqiptare të Futbollit dhe negociemeve paraprake, shprehin vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë Palët duke shprehur vullnetin e tyre të lirë deklaruan se bien dakord të nënshkruajnë këtë kontratë, në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 7850 datë 29.7.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, të nënshkruajnë këtë Marrëveshje sipas termave që vijojnë:

Neni 1

Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate, është bashkëpunimi i palëve për rindërtimin dhe menaxhimin e stadiumit "BESA", sipas termave dhe kushteve të kësaj akt marrëveshje.

Me nënshkrimin e kësaj akt marrëveshje, palët bien dakord që do të kryejnë procedurat per ndertimin e stadiumit, sipas Aneksit 1 (grafiku i punimeve) dhe sipas Aneksit 2 (specifikime teknike) si dhe ne përputhje me projektin e hartuar dhe miratuar nga FSHF, pjesë të pandara të kësaj Marrëveshje.

Neni 2

Të Drejtat dhe Detyrimet e Palëve

- 1.1 Bashkia Kavaje, do të sigurojë të gjithë mbështetjen ligjore dhe teknike per rindërtimin e stadiumit "BESA", Kavaje, ne rast se do te jete e nevojshme.
- 2.2 Të dyja palët janë bashkë financuese të këtij projekti me vlere 500 000 000 (pesëqind milion) Leke, ku:
 - a. **Bashkia Kavajë do të investojë vlerën prej 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milion) Leke;**
 - b. **Federata Shqiptare e Futbollit do të investojë vlerën prej 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milion) Leke.**
- 2.3 Punimet duhet të realizohen sipas Specifikimeve Teknike, sipas projektit dhe zbatimit të tij, në përputhje të plotë me normat teknike dhe njëkohësisht duke treguar kujdesin e duhur, në mënyrë që vepra e përfunduar t'i përgjigjet plotësisht asaj çka është parashikuar nga dokumentet kontraktuale dhe nevojave të përdorimit për të cilat u ndërta.
- 2.4 FSHF do të përzgjedhë projektin arkitektonik të stadiumit sipas kriterëve të përcaktuara në procedurat e institucionit të saj.
- 2.1 Federata Shqiptare e Futbollit është autoriteti që do të zhvillojë dhe përzgjedhë projektin e zbatimit me anë të prokurimit sipas kriterëve të përcaktuara në procedurat e institucionit të saj. Në përzgjedhjen e projektit do të jenë anëtarë edhe përfaqësues të Bashkisë Kavajë.
- 2.2 Investimi total, do të realizohet si më poshtë:
 - a. Gjatë fazës së miratimit të projektit, Bashkia Kavajë do të kontribuojë me 70% të vlerës së projektit, ndërsa Federata Shqiptare e Futbollit do të kontribuojë ne masën 30%. Bashkia Kavajë do te disbursohet kundrejt faturimit online në sistem, për llogari të Operatorit Ekonomik fitues.
 - b. Pjesa tjetër e investimit, do te disbursohet kundrejt faturimit online ne sistem, në përputhje me situacionet gjatë fazës ndërtimore, te cilat do të ndahen në raportin, 70% nga Bashkia Kavajë dhe 30% nga Federata Shqiptare e Futbollit.
- 2.3 Bashkia Kavajë merr përsipër si përfituese e investimit të mbulojë ose të zerojë taksën e ndikimit në infrastrukturë për këtë projekt rindërtimi, duke e miratuar në Këshillin Bashkiak me vendim.
- 2.4 Procedura për përzgjedhjen e projektit fitues, zbatimit të projektit dhe supervizionimit të punimeve do te kryhet nga te dyja palët FSHF dhe Bashkia Kavaje.
- 2.5 Bashkia Kavaje ka detyrimin të vendosë në dispozicion të FSHF-së këtë stadium pas përfundimit, pa shpërblim për nevojat e ekipeve kombëtare për aktivitete futbollistike të ndryshme për të cilat do të bien dakort palët.

Neni 3

Mirëmbajtja e Stadiumit

- 3.1 Mirëmbajtja ose punimet e strukturave të stadiumit, që bëhen të nevojshme në çfarëdolloj momenti pas përfundimit të punimeve dhe/apo gjatë tyre, për çfarëdolloj arsyeje qoftë kjo një forcë madhore, gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje, janë në ngarkim të pronarit të stadiumit.
- 3.2 Bashkia Kavaje, do të vendosë në afërsi të stadiumit një pllakate me këtë tekst: "Ky projekt u mundësua me financimin e Federatës Shqiptare të Futbollit".

Neni 4

Të ardhurat dhe pagesat

Palët bien dakord që Bashkia Kavaje, është titullar i stadiumit "BESA" dhe i te gjitha te ardhurave te mbledhura nga ndeshjet e K.S.BESA. Te ardhurat nga ndeshjet te cilat organizohen nga FSHF i takojnë kësaj te fundit.

2 Të ardhurat nga organizimi i ndeshjeve në kuptim të këtij paragrafi nënkupton shitjen e biletave, të ardhurat nga sponsorët, dhe çdo të ardhur tjetër që përfitohet gjatë ndeshjes ose si pasojë e saj.

Neni 5

Lidhja mes palëve

Palët deklarojnë që kjo Marrëveshje nuk krijon asnjë lidhje të veçantë ekonomike, juridike ose financiare mes tyre përveç detyrimeve të marra përsipër shprehimisht prej tyre.

Neni 6

Njoftimet

Njoftimet sipas kësaj kontrate duhet të jenë me shkrim dhe të dërgohen në adresën postare ose elektronike të mëposhtme:

Bashkia Kavaje:

Kontakti: Tel 0684068405

Adresa postare: Rruga "Josif Budo", Ndërtesa Nr. 16, 2501 Kavajë

Adresa elektronike: info@bashkiakavaje.gov.al

Federata Shqiptare e Futbollit:

Adresa postare: Rr. Liman Kaba, Nd 5, Hyrja 1, Njësia Administrative 5, Kodi Postar 1019, Tirane,

Adresa elektronike: info@fshf.al

Neni 7

Zgjidhja e Marrëveshjes

7.1 Çdo mospërbushje që mund të sjellë zgjidhjen e kontratës duhet t'i njoftohet paraprakisht me shkrim Palës që është në shkelje.

7.2 Palët do përipiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e lindura gjatë ose për shkak të kësaj kontrate.

Neni 8

Informacioni konfidencial

8.1 Palët duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

8.2 Palët mund të shkëmbejnë dokumente të tilla, të dhëna ose informacione të tjera deri në masën e kërkuar për zbatimin e kontratës.

8.3 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, palët duhet t'i vendosin në dispozicion njëra-tjetrës të gjitha provat dhe informacionin në posedim të tij të cilat kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 9

Ndryshimi i punimeve

9.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt ri negocimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e saj. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe i firmosur nga Palët.

9.2 Përpara se të kërkojë një ndryshim Palët duhet të bien dakord për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës, të volumeve të punimeve dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Punimet e ndryshuara duhet të materializojnë amendamentet e marrëveshjes.

Neni 10
Forca madhore

- 10.1 Asnjë palë nuk do të ndëshkohet për dështime për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës kur këto shkaktohen për arsye të ngjarjeve të pakontrollueshme, të paparashikuara, të pakapërcyeshme dhe përtej kontrollit.
- 10.2 Pavarësisht nga sa më sipër, palët të paaftë për të përmbushur detyrimet e tyre për arsye të shkaqeve të referuara më sipër, do të përdorë të gjitha afërsitë e tij për të shmangur apo kapërcyer pengesa apo rrethana të tilla.
- 10.3 Nëse pala do të jetë e justifikuar nga mosrealizimi për shkak të forcave madhore, ai do të rifillojë realizimin menjëherë sapo ky shkak ose paparashikim të jetë eliminuar.
- 10.4 Kjo palë do t'i japë palës tjetër njoftimin për ekzistencën e këtij rasti apo parashikimi. Në rast se realizimi i punimeve është shtyrë për shkak të forcës madhore afati shtyhet për aq kohë sa ka vazhduar forca madhore.

Neni 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 11.1 Palët duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje, me negociata direkte.
- 11.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së saj sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.
- 11.3 Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Shkalles së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane.

Neni 12
Të ndryshme

- 12.1 Çdo heqje dorë nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 13
Gjuha e kontratës

- 13.1 Kjo kontratë përbëhet nga 4 (kater) faqe dhe hartohet në dy kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë ligjore e ekzekutive.
- 13.2 Pasi u lexua me zë dhe u gjet në përputhje me vullnetin e lirë të palëve, u nënshkrua si me poshtë.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të saj nga palët dhe miratimit të saj nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Kavaje.

KRYETARI
FISNIK QOSJA
NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
ARTI ÇICOËLLI

FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
ILIR SHULKU

